



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

V E N D I M

Nr. 20, Datë 21/02/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 106, datë 03.09.2019, e Znj. V. A., ku pretendohet diskriminim i vajzave të saj, binjake, 16 vjeçare, për shkak të “*gjendjes shoqërore*”, nga ana e Znj. B. P.dhe Znj. A. R., mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas ankuesit.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se K dhe E. I., vajzat e ankueses V. A. kanë ndjekur arsimin 9-vjeçar pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Ankuesja shpreh shqetësimin e saj se përgjatë vitit shkollor 2017-2018, ndërkohë që të bijat ndiqnin klasën e IX pranë kësaj shkolle, kanë qenë viktime të bullizmit nga ana e shokëve dhe shoqeve të klasës, ku ato mësonin. Bullizmi konsistonte në tallje, ofendime dhe veçim, të cilat kanë patur ndikim tepër negativ në shëndetin e tyre. Vajzat e saj, të cilat janë binjake, shprehen se janë ankuar tek mësuesja kujdestare B. P., e cila nuk i ka marrë parasysh ankimet e nxënësve të saj, ndërkohë Znj. V. A. pretendon se detyra e kësaj mësueseje ka qenë të ndërhyjë, për të socializuar vajzat e saj me pjesën tjetër të nxënësve. Ankuesja pretendon se vajzat e saj

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

diskriminoheshin për shkak të gjendjes shoqërore, pasi ato janë binjake dhe shumicën e kohës, shoqëroheshin me njëra tjetrën. Znj. V. A. thekson faktin se gjendja shëndetësore dhe psikologjike e të bijave rëndohej dita-ditës, pasi ato kaluan në anoreksi, ankth dhe në mos shoqërim me moshatarët e tyre.

Ankuesja shprehet se është paraqitur në shkollë dhe ka takuar drejtoreshën e në vijim mësuesen kujdestare, ku kjo e fundit e ka neglizhuar situatën dhe për më tepër filloi t'i bullonte edhe vetë vajzat, duke i veçuar, duke mos i ndihmuar dhe ofenduar ato gjatë orëve të mësimi. Ankuesja pretendon se edhe mësuesja e Histori-Gjeografisë dhe Edukatës Shoqërore, Znj. A. R. i ka bulluar vajzat e saj gjatë orëve të mësimi, gjë që ka ndikuar negativisht në gjendjen e tyre, psikologjike. Si pasojë e bullizmit ndaj të cilit dy vajzat ishin ekspozuar, ato filluan që të mungonin në shkollë dhe ranë ndjeshëm në mësim. Ankuesja bën përgjegjëse për situatën konkrete, dy mësueset e sipërpërmendura, të cilat me sjelljen dhe reagimin e tyre, jo vetëm nuk e ndaluan bullizmin e nxënësve të tjerë ndaj dy vajzave të saj, por njëkohësisht ishin nxitëse të këtij bullizmi, duke i bulluar edhe ato vetë. Ankuesja V. A. sqaron gjithashtu se ajo ka marrë dijëni mbi diskriminimin e vajzave të saj, me vonesë, përkatësisht në muajin nëntor 2018, pasi E. dhe K. I. nuk i kanë treguar nënës së tyre, për bullizmin e ushtruar në ambientet shkollore.

Aktualisht, vajzat e kanë përfunduar klasën e IX pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë dhe gjendja e tyre psikologjike dhe shëndetësore mbetet e njëjtë, prej bullizmit nga i cili kanë vuajtur më parë. Ato refuzojnë të ndjekin arsimin e mesëm pranë gjimnazit, ku aktualisht janë regjistruar të njëjtët nxënës, me të cilët ato kanë qenë në të njëjtën klasë pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 106, datë 03.09.2019, së znj. V. A., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

B. Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 1300, datë 11.09.2019, Znj. B. P.dhe Znj. A. R., mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, ku kërkohej informacion, lidhur me situatën e parashtruar nga Znj. V. A.. Shkresa e sipërpërmendur iu dërgua për dijeni edhe Drejtores së Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë dhe ankueses.

1. Në përgjigje të shkresës së sipërpërmendur, mësuesja B. P.dërgoi shkresën nr. 1300/2, datë 23.09.2019, nëpërmjet së cilës informon se ajo ushtron profesionin e mësuesit pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Ajo shprehet se ka mbetur e surprizuar nga ankesa dhe thekson faktin se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe i padrejtë.

Znj. B. P.sqaron se në cilësinë e mësuesit kujdestar, ajo ka treguar kujdes maksimal dhe ka trajtuar me prioritet çdo shqetësim, që është shfaqur nga çdo nxënës i klasave, ku është impenjuar në mësimdhënie, duke patur fokus të veçantë në klasën e saj kujdestare.

Në lidhje me ish-nxënëset e saj, K dhe E. I., ajo shprehet se ka patur një komunikim të mirë me to. Ajo thekson faktin se ka patur gjithashtu edhe një komunikim tepër bashkëpunues me nënën e tyre, në lidhje me ecurinë në mësim të vajzave të saj, duke mbajtur komunikim të vijueshëm për çdo problematikë gjatë viteve mësimore, deri në përfundimin e ciklit 9-vjeçar të shkollimit të vajzave

Në lidhje me pretendimin e shfaqjes së bullizmit ndaj vajzave apo mosmarrjes së masave nga ana e saj në cilësinë e mësueses kujdestare, Znj. B. P.shprehet se është i pavërtetë dhe i kundërt me situatën reale. Ajo sqaron se ka patur komunikim personal, nëpërmjet telefonit me znj. V. A. dhe ka ndarë me të çdo shqetësim mbi dinamikën dhe ecurinë e shkollimit të Katias dhe Emës, duke mos konstatuar për asnjë moment ndonjë problem në lidhje me mësimnxënien e tyre.

Znj. B. P. thekson faktin se objekti i ankesës së paraqitur pranë KMD-së është i para dy viteve. Njëkohësisht ajo përmend faktin se një ankesë e tillë i ka shkaktuar shqetësim dhe se është i padrejtë dhe nuk është e mbështetur.

Në përfundim, Znj. B. P. shprehet se ka bërë përpjekje maksimale për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për krijimin e një klime normale brenda ambienteve të klasës, kujdestarinë e së cilës ka patur. Për këtë arsye, nuk gjen dot asnjë shkak objektiv për të justifikuar ankesën kundër saj.

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Ndërkohë që, për sjelljet bulliste ajo shprehet se nuk ka konstatuar për asnjë moment një situatë të tillë, pasi për çdo problematikë të shfaqur, në të gjitha rastet e ka konsultuar dhe trajtuar me personat përgjegjës të shkollës dhe me prindërit e fëmijës.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 1300, datë 11.09.2019, të Komisionerit, mësuesja Ariana A. R. dërgoi shkresën nr. 1300/4, datë 07.10.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se ajo e ushtron profesionin e mësueses së histori-gjeografisë prej 31 vitesh. Znj. A. R. shprehet se ka punuar gjithmonë me ndershmëri dhe integritet profesional. Gjatë gjithë eksperiencës së saj si mësuese është përpjekur të jetë mike dhe aleate e çdo nxënësi.

Referuar shkresës në fjalë, Znj. A. R. ka punuar pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu” që prej vitit 2005 dhe gjithmonë ka patur një marrëdhënie shumë të mirë me nxënësit dhe kolegët. Ajo e bën me dije Komisionerin se që prej vitit 2015 e në vijim punon me kohë të pjesëshme, konkretisht me $\frac{3}{4}$ e kohës së punës, pasi ka kaluar një sëmundje të rëndë. Gjatë gjithë viteve të saj të punës, nuk ka marrë asnjëherë vërejtje apo masa disiplinore nga eprorët dhe për të nuk ka patur asnjëherë ankesë nga prindërit e nxënësve, nxënësit apo kolegët.

Lidhur me objektin e ankesës në shqyrtim, ajo shprehet se ajo nuk ka patur asnjëherë kontakt me Znj. V. A.. Kontakti i saj ka qenë vetëm me 2 nxënës gjatë orëve të lëndës së gjeografisë. Njëkohësisht, Znj. A. R. shprehet se nuk ka patur asnjëherë sinjalizim për bullizëm ndaj vajzave të Znj. V. A., nga ana e mësueses kujdestare, psikologjia e shkollës, drejtorja, senati i klasës, këshilli i prindërve apo edhe nga vetë prindërit e vajzave.

Ajo shprehet se Katian dhe Emën i ka aktivizuar vazhdimisht në klasë, në punë individuale apo edhe në grup, ka punuar me to, por kurrësesi në asnjë moment nuk ka ushtruar bullizëm ndaj tyre. Znj. A. R. sqaron se nuk ka përdorur asnjëherë lëndimin, si mënyrë për të dëmtuar vetëvlerësimin e tyre, si dhe nuk ka kryer asnjë veprim apo mosveprim të ndërgjegjshëm për t'i lënduar vajzat, apo për t'i vendosur vajzat nën stres. Në asnjë rast nuk ka ushtruar dhune fizike apo psikologjike ndaj tyre, apo nuk ka nxitur në asnjë moment përjashtimin e tyre gjatë lojrave dhe aktiviteteve të organizuara.

Znj. A. R. shprehet se kjo ankesë ndikon negativisht tek ajo, qoftë në aspektin personal, ashtu edhe në atë psikologjik e personal.

Njëkohësisht, mbështetur në dispozitat e LMD, ajo shprehet se ankesa është depozituar pranë KMD-së, tej afatit ligjor.

3. Në përgjigje të shkresës nr. 1300, datë 11.09.2019, të Komisionerit, u dërgua shkresa nr. 166, datë 30.09.2019, e Drejtores së Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, nëpërmjet së cilës jepen sqarime mbi situatën e parashtruar në ankesë.

Drejtoresha e kësaj shkolle, Znj. S. A.shprehet se prej pothuajse 1 viti ushtron detyrën e drejtoreshës dhe më herët ka mbajtur pozicionin e nëndrejtoreshës pranë së njëjtës shkolle. Ajo sqaron se ka qenë gjithmonë në dijeni të problematikave që kanë shoqëruar procesin mësimor gjatë viteve dhe është angazhuar gjithmonë në zgjidhjen dhe sqarimin e tyre.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Znj. V. A., fillimisht Znj. S. A.ka marrë dijeni në muajin prill të një viti më parë, kur ankuesja kërkonte dëshmipërbllim nga mësuesja kujdestare për keqtrajtimin psikologjik të vajzave të saj. Mbi këtë rast janë zhvilluar konsultat përkatëse prind-nxënës-staf pedagogjik dhe pas këtij momenti nuk ka patur më asnjë problematikë, deri në momentin e paraqitjes së ankesës pranë KMD-së.

Znj. S. A.shprehet se ka qenë prezente dhe dëshmitare e mënyrës së trajtimit të nxënësve përgjatë gjithë orarit të zhvillimit të mësimin. Ajo thekson faktin se vlerësimet e saj janë maksimale ndaj gjithë stafit pedagogjik, e në veçanti ndaj mësueseve, ndaj të cilave janë ngritur pretendime të padrejta.

Ajo sqaron se në periudha ciklike përgjatë vitit mësimor janë zhvilluar pyetësorë dhe anketa me nxënësit, në lidhje me procesin e mësimnxënies, sikurse edhe mbi problematika të tjera, që ata i shqetësojnë. Në asnjë rast nuk ka rezultuar që nxënëset K dhe E. I. të kenë shfaqur ndonjë problem, për më tepër që edhe në komunikimin dhe shfaqjen e jashtme mes shokësh nuk është konstatuar dhe as demonstruar ndonjë sjellje jashtë përditshmërisë.

Drejtoresha e Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë thekson faktin se duke qenë në kontakt të vazhdueshëm mbi çdo problematikë, në lidhje me gjithë procesin mësimor në tërësi, mbi ankesat e mundshme, si dhe duke njohur aftësitë mësimdhënëse dhe menaxheriale të dy mësueseve, në vlerësimin e saj, ankimi i Znj. V. A. është plotësisht i pabazë.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 03.12.2019, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqitën palët, sikurse edhe drejtoresha e Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë dhe përfaqësues të ZVA Tiranë, të cilët Komisioneri i kishte ftuar në seancë dëgjimore, për të parashtruar rezultatet e hetimit, që ky institucion ka kryer mbi rastin e vajzave të znj. V. A.³. Ankuesja V. A. shoqërohej nga dy vajzat e saj në këtë seancë dëgjimore.

Znj. V. A. parashtroi edhe një herë pretendimet e saj ndaj znj. B. P. dhe znj. A. R., mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Ajo sqaroi se shqetësimet ndaj vajzave të saj kanë filluar gjatë periudhës kohore, që ato kanë qenë duke ndjekur fundin e klasës së tetë dhe gjatë

³ Referuar informacionit të përcjellë pranë KMD-së nga ankuesja rezulton se kjo e fundit ka depozituar ankesë ndaj mësueseve respektive edhe pranë ZVA Tiranë dhe pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

klasës së nëntë, pranë shkollës së sipërpërmendur. Znj. V. A. u shpreh se gjatë asaj periudhe kohore e në vijim, ajo kishte vënë re ndryshim në sjelljen e vajzave të saj, të cilat kanë patur rënie në mësim, mungesa në shkollë, mbyllje në vetëvete, si dhe ndryshim në veshje, pasi kishin filluar të visheshin me rroba të errëta, në vend të rrobave me ngjyra, që dikur ato vishnin. Znj. V. A. u shpreh se ajo është vënë në dijeni të bullizmit, nga i cili, vajzat e saj vuanin, në një moment më të vonë, nga momenti që ai kishte ndodhur, pasi ato nuk i tregonin për problemet që ato kishin me mësueset dhe shokët e klasës. E pyetur për arsyen e bullizmit të pretenduar, ajo u shpreh se mendonte se një nga arsyet e tij ka qenë fakti që vajzat e saj nuk kanë kontribuar në disa aktivitete që kishte zhvilluar shkolla, si pasojë e pamundësisë ekonomike. Znj. V. A. u shpreh se ajo është e divorcuar dhe e po rriste e vetme dy vajzat e saj binjake. Ajo theksoi faktin se vajzat e saj kanë humbur një vit mësimor pas përfundimit të shkollës 9-vjeçare, pasi refuzonin të regjistroheshin pranë së njëjtës shkollë të mesme, tek e cila ishin regjistruar dhe ndiqnin mësimin ish-shokët e shoqet e klasës së tyre. Aktualisht, K dhe E. I. kanë fituar konkursin dhe janë pranuar për të ndjekur Liceun Artistik “Jordan Misja”, Tiranë, në degën art grafik, pasi të dyja vajzat janë cilësuar si talente në këtë fushë, ndërkohë që në shkollën 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, atyre nuk u është vënë asnjëherë në dukje një talent i tillë dhe nuk janë promovuar kurrë në këtë aspekt. Jeta e tyre është përmirësuar dukshëm, falë përkushtimit dhe sjelljes tepër të mirë të mësuesve dhe stafit drejtues të këtij institucioni arsimor. Por, pavarësisht sa më sipër, ankuesja sqaron se e kaluara e vajzave pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë është tepër shqetësuese, pasi bullizmi ndaj tyre, përforcohej si pasojë e përkrahjes së nxënësve bullues nga ana e mësueseve B. P.dhe znj. A. R.

Znj. Beneta Peposhi, u shpreh se ka patur marrëdhënie shumë të mira, si me dy nxënëset, ashtu edhe me nënën e tyre, gjatë periudhës kohore që, K dhe E. I. ndiqnin shkollën 9-vjeçare dhe ajo ishte mësuesja e tyre, kujdestare. Ajo sqaroi se dy vajzat nuk ishin ankuar asnjëherë për bullizëm tek mësuesja kujdestare. Ajo u shpreh se K dhe E. I. rrinin të veçuara nga pjesa tjetër e klasës dhe ky veçim ka ardhur si rrjedhim i dëshirës së tyre. Ato kanë patur zënka me shokët e klasës në disa raste. Ajo theksoi faktin se në rastet kur, vajzat nuk paraqiteshin dhe mungonin në shkollë, ajo ka njoftuar nënën e tyre. Rastet, kur janë krijuar situata të tilla, në cilësinë e mësues kujdestare, ajo i ka bërë të ditura dhe i ka adresuar pranë drejtorisë së shkollës. E pyetur se cilat janë masat e marra nga mësuesja kujdestare për të rregulluar situatat e sipërpërmendura, znj. B. P.u shpreh se ishte munduar të rriste frymën e shoqërimit ndërmjet binjakeve dhe pjesës tjetër të klasës.

Ndërkohë, znj. S. A., drejtoresha aktuale e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, sqaroi se në periudhën kohore kur vajzat ndiqnin shkollën, ajo ka mbajtur pozicionin e nëndrejtoreshës së kësaj shkolle. Ajo sqaroi se është vënë në dijeni të këtyre problematikave dhe pretendime për bullizëm, vetëm, pasi vajzat kanë përfunduar shkollën 9-vjeçare. E pyetur mbi mënyrën se si

zgjidhet një problematikë e lindur me nxënësit e kësaj shkolle, drejtoresha u shpreh se në çdo rast njoftohet psikologu i shkollës, i cili trajton rastin konkret. Ajo u shpreh se dy vajzat binjake kanë qenë rebele dhe përdornin fjalor të pahijshëm në ambientet e shkollës. Ajo sqaroi se problematika e bullizmit nuk është ngritur asnjëherë nga vajzat. Vajzat largoheshin nga mësimi dhe mungesat janë të faktuara. Ato janë veçuar me dëshirën e tyre. Lidhur me mungesën e tyre në orët e mësimi, drejtoresha e shkollës shprehet se nëna e tyre duhet ta kishte parë këtë fakt si shqetësim.

Ndërkohë, znj. V. A. u shpreh se vajzat e saj nuk e kanë informuar mbi gjendjen e tyre dhe ajo nuk kishte patur dijeni mbi situatën e krijuar. E pyetur nëse shkolla e tyre kishte psikolog, drejtoresha e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, u shpreh se shkolla e tyre ka patur dhe ka psikolog. Në këtë kontekst, drejtoreshës së kësaj shkolle iu kërkua që të depozitonte aktet e hartuara nga psikologjia e shkollës për K dhe E. I., për të analizuar problematikat e tyre, si dhe mënyrën që është ndjekur për të sistemuar situatën konkrete.

Përfaqësuesja (psikologe) e ZVA Tiranë, Znj. O. J. u shpreh se në kuadër të shqyrtimit dhe hetimit të kësaj çështjeje nga ZVA Tiranë, asaj i ishte ngarkuar si detyrë të hartonte një pyetësor për nxënësit e kësaj shkolle. Ajo u shpreh se është e mendimit, që rasti i vajzave nuk i është referuar psikologut, pasi problematika nuk ka qenë aq e madhe, ose rasti është neglizhuar.

Mësuesja B. P. u pyet nëse rasti i dy vajzave binjake është përcjellë tek psikologu i shkollës. Ajo u përgjigj se ky rast nuk ka qenë aq i agravuar dhe psikologu i shkollës nuk është njoftuar. Ndërkohë që, drejtoresha e shkollës u shpreh se ankuesja ka patur një bisedë me psikologun e shkollës. Ajo sqaroi se raste të tilla në një shkollë 9-vjeçare, ka çdo ditë. Rastet e agravuara janë ato që konsistojnë në thyerjen e Rregullores së Shkollës. Drejtoresha e shkollës shprehet se në dijeninë e saj, rasti i dy vajzave binjake është ndjekur nga psikologu i shkollës.

Përfaqësuesja (juriste) e ZVA Tiranë u shpreh se pasi znj. V. A. ka ngritur shqetësimin e saj, në shtator 2019, ZVA Tiranë ka kryer inspektim tek stafi i Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, si dhe kanë patur kontakte me drejtoreshën e kësaj shkolle, nga ku janë vënë në dijeni të faktit se problemet për K dhe E. I.n, janë shfaqur pas përfundimit të shkollës 9-vjeçare. Problemi konsistonte në mospërshtatjen e tyre me pjesën tjetër të klasës, ku ato mësonin. Prindi i tyre kishte ndikuar që ato të rrinin të veçuara nga pjesa tjetër e klasës. Anketimi i kryer nga psikologu i shkollës ka dalë në përfundimin se nxënësit nuk kanë problematika me mësuesit. Përfaqësuesja (psikologe) e ZVA Tiranë u shpreh se problemet e vajzave janë shfaqur, pasi ato janë larguar nga shkolla 9-vjeçare. Nëse psikologu do të kishte trajtuar rastin e tyre do të kishte dalë me një rekomandim, pra me një akt të dokumentuar. Ajo shprehet se ka kërkuar për një akt

të tillë, por nuk e ka gjetur. Një gjë e tillë tregon se rasti konkret nuk ka qenë i një rendësie madhore.

Ankuesja theksoi faktin se, në muajin shtator 2019, ka depozituar ankesë pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë dhe nuk ka marrë asnjë përgjigje për këtë ankesë.

Znj. A. R. u shpreh se nuk ka patur dijeni për një situatë të tillë dhe ajo i ka aktivizuar gjithmonë vajzat në grupe pune. Ajo u shpreh se ka punuar me kohe të pjesëshme në këtë shkollë, për shkak të një sëmundjeje të rëndë që kishte kaluar. E. dhe K. I. u shprehën se është e vërtetë që mësuesja A. R. i ka aktivizuar në mësim, por ajo i ka trajtuar me tallje në çdo situatë. Vajzat tregojnë një rast që i ka ndodhur njëres prej tyre, kur është ngritur në mësim në orën e gjeografisë dhe i është kërkuar nga znj. A. R., të orientohet në hartë me sy të mbyllur.

Të pyetura nga psikologjia e ZVA Tiranë, nëse e kanë takuar ndonjëherë psikologjen e shkollës, Ema Ismaili u përgjigj se nuk e ka takuar asnjëherë atë. Të pyetura nga përfaqësuesit e KMD-së, nëse përgjatë gjithë viteve që kanë ndjekur shkollën 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë të dyja vajzat kanë mësuar me të njëjtët nxënës apo përbërja e klasës ka ndryshuar ndër vite, Ema dhe Katia Ismaili u përgjigjën se ato kanë mësuar gjithmonë me të njëjtët nxënës dhe bullizmi ndaj tyre ka filluar vetëm në fund të klasës së tetë dhe gjatë klasës së nëntë. E pyetur nëse vajzat përfshiheshin në aktivitetet e zhvilluara nga shkolla apo klasa, mësuesja B. P. u shpreh se ajo i ka përfshirë në çdo aktivitet të dyja vajzat. Ndërkohë që, nëna e vajzave u shpreh se në mbrëmjen e minimaturës, vajzat e saj nuk janë ftuar. Vetë vajzat u shprehën se, para mbrëmjes së minimaturës, disa prej nxënësve të klasës i kanë vënë në lojë, lidhur me pamjen e tyre, pavarësisht se ato nuk kanë asgjë për t’u tallur lidhur me aparcencën e tyre. Znj. B. P. sqaroi se pjesëmarrja në këtë mbrëmje është me dëshirë dhe vajzat nuk kanë patur dëshirë për të marrë pjesë në këtë mbrëmje.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri dërgoi shkresën nr. 1916, datë 17.12.2019, në adresë të Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, ku kërkohej informacion mbi çështjet e mëposhtëme:

- Kopje e Rregullores së Brendshme të Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë;
- Kryerja e verifikimeve përkatëse, nëse K dhe E. I. janë trajtuar nga psikologjia e shkollës. Nëse po, të përcillen pranë KMD-së, aktet përkatëse të hartuara nga psikologjia;
- Informacion mbi veprimtarinë e psikologes së shkollës përgjatë dy viteve shkollorë, që përkojnë me periudhën kohore, kur K dhe E. I. kanë ndjekur klasën VIII-IX.
- Informacion mbi numrin total të mungesave të kryera nga K dhe E. I., përgjatë klasës së VIII dhe klasës IX. Në këtë informacion të evidentohen mungesat e justifikuara dhe ato të

pajustificuara nga prindi. Të dërgohen gjithashtu kopje të evidencave, që disponohen nga drejtoria e shkollës, mbi mungesat e kryera nga vajzat;

- Kopje e dëftesave të K dhe E. I., nga klasa V-IX.
- Informacion lidhur me përfundimet e anketimeve të kryera me nxënësit e Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, përgjatë viteve shkollorë, që përkojnë me periudhën kohore, kur K dhe E. I., kanë ndjekur Klasën VIII-IX.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 1916, datë 17.12.2019, së Komisionerit, Shkolla 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, dërgoi shkresën nr. 65, datë 15.01.2020 dhe shkresën nr. 1946, datë 23.12.2019, nëpërmjet së cilave dërgoi informacionin e kërkuar.

Në këto shkresa, drejtoresha e shkollës sqaron se në Shkollën 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, nuk ka asnjë procesverbal, në të cilin të jenë trajtuar raste bullizmi, ose raste të tjera ndaj nxënëseve E. dhe K. I. Psikologia e shkollës nuk disponon asnjë rast të trajtuar për bullizëm ndaj dy vajzave. Në materialet dhe dokumentacionin shkollor (regjistra, mungesa) rezulton se ecuria e vajzave është konstante e jo në rënie, sikurse është pretenduar nga ankuesja.

Në të gjithë pyetësorët që ka zhvilluar Drejtoria e Shkollës, psikologia e shkollës, si dhe Zyra Vendore Arsimore Tiranë, nuk rezulton që mësueset A. R. dhe B. P. të klasifikohen si mësuese që kanë ushtruar bullizëm. Përkundrejt pretendimit të znj. V. A., që nxënëset E. dhe K. I. nuk janë vlerësuar në orën e vizatimit, vihet në dukje fakti, që kjo lëndë rezulton e vlerësuar maksimalisht me notën 10-të (dhjetë).

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr. 106, datë 03.09.2019, e Znj. V. A., Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 106, datë 03.09.2019, e Znj. V. A., pretendohet diskriminim i vajzave të saj, binjake, 16 vjeçare, për shkak të “gjendjes shoqërore”, nga ana e Znj. B. P. dhe Znj. A. R., mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të hetimit administrativ rezulton se E. dhe K. I., lindur në datën 24.11.2002, në Berat, kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Në procesin e shqyrtimit administrativ të ankesës, vajzat

përfaqësohen ligjërisht pranë KMD-së nga ana e nënës së tyre, pasi ato janë ende nën moshën 18 vjeç dhe nuk kanë zotësi të plotë veprimi. Mbështetur në pretendimet e parashtruara në ankesë, rezulton se gjatë periudhës kohore, që vajzat e saj kanë ndjekur klasën e tetë, që përkon me vitin shkollor 2016-2017 dhe klasën e nëntë që përkon me vitin shkollor 2017-2018, kanë patur ndryshim të ndjeshëm në sjelljen e tyre dhe mënyrën e jetesës. Ndryshimi ka qenë negativ, pasi sipas nënës së tyre, vajzat filluan të bënin mungesa të shumta në shkollë, u mungonte dëshira për të frekuentuar shkollën dhe si rrjedhim kishin rënie të ndjeshme në mësim. Gjendja e tyre ishte e shoqëruar me ankth, ndërprerje të marrjes së ushqimit dhe mos shoqërim me shokë e shoqe të moshës së tyre. Në vijim, nëna e vajzave u vu në dijeni të faktit se ato bulloheshin nga nxënësit e klasës, si dhe nga mësuesja kujdestare B. P.e mësuesja A. R. Bullizmi konsistonte në tallje, ofendime dhe në mungesën e marrjes së masave të menjëherëshme e të nevojshme, nga ana e mësues kujdestare, për të ndaluar situatën e bullizmit. Ankuesja shprehet se mësuesja kujdestare ishte në dijeni të asaj që po ndodhte me dy vajzat binjake dhe nuk vepronte. Gjendja psikologjike dhe shëndetësore e vajzave sa vinte e rëndohej. Referuar recetave të lëshuara nga mjeku i familjes, Dr. N. K. rezulton se E. dhe K. I. vuajnë nga anemia dhe mjeku thekson faktin se ka dyshim, se të dyja vajzat vuajnë nga anoreksia dhe duhet të vizitohen tek psikologu. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja u pyet nëse ishte këshilluar me ndonjë psikolog për gjendjen e vajzave. Ajo u shpreh se nuk mundej të përballonte financiarisht shpenzimet e vizitave tek psikologu dhe për këtë arsye nuk i kishte vizituar vajzat e saj tek një specialist psikolog.

Në kushtet kur, nuk disponohen akte të mjekut specialist psikolog, i cili mund të vërtetonte gjendjen reale, shëndetësore të dy vajzave në periudhën, kur sipas pretendimeve të znj. V. A., gjendja ka qenë kritike për to, si pasojë e bullizmit të pretenduar, Komisioneri mori në shqyrtim provat dhe faktet, që mund të vërtetojnë në mënyrë indirekte pasojat, që mund të kenë ardhur si pasojë e bullizmit të pretenduar ndaj E. dhe K. I. Sikurse theksohet edhe më sipër nga ankuesja, si pasojë e bullizmit të ushtruar ndaj tyre nga shokët e klasës dhe dy mësueset e sipërpërmendura, vajzat kanë patur rënie të ndjeshme në mësim dhe kanë kryer mungesa të shumta, pasi ndaluan së frekuentuari rregullisht shkollën. Për të faktuar sa më sipër, Komisioneri mori në shqyrtim aktet e dërguara në cilësi prove nga Shkolla 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë.

Referuar Vërtetimeve me nota të lëshuara nga Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, rezulton se numri i mungesave dhe notat mesatare të nxënësve Ema dhe Katja Ismaili, nga klasa e VI deri në klasën e IX, është si vijon:

Tabela - Mungesat dhe notat mesatare vjetore të E. dhe K. I. nga klasa VI-IX.

Klasa	Ema Ismaili			Katja Ismaili		
	Mungesat		Mesatare e notave	Mungesat		Mesatare e notave
	Me arsye	Pa arsye		Me arsye	Pa arsye	
VI	29	1	8.1	24	-	8
	30			24		
VII	41	8	7.5	53	8	7.3
	49			61		
VIII	46	1	7.5	45	1	7.4
	47			46		
IX	87	15	7.1	96	9	7
	102			105		

Në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë, të vitit 2018 – 2019, **K. I.** ka patur këto rezultate: Gjuhë shqipe–8 (tetë); Matematikë -7 (shtatë), Gjuhë e huaj e parë (anglisht)–8 (tetë);

Në Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë, të vitit 2018 – 2019, **E. I.** ka patur këto rezultate: Gjuhë shqipe–8 (tetë); Matematikë-6 (gjashtë), Gjuhë e huaj, e parë (anglisht)–8 (tetë);

Për sa më sipër, rezulton se ka rënie në mesataren e të dy vajzave me 1 notë, nga klasa e VI në klasën e IX, ndërkohë që vihet re shtimi i numrit të mungesave, mbi 100 të tilla në klasën e IX, për të dyja vajzat.

Znj. V. A. ka depozituar në cilësinë e provës Dëftesat e Lirimit të klasës së IX dhe ato të klasës së V-të për të dyja vajzat. Referuar Dëftesave të klasës së pestë rezulton se Ema dhe Katja Ismaili kanë patur një notë mesatare vjetore 9.1 dhe 9.2, për secilën, ndërkohë që mungesat e tyre janë të pakta, 14 mungesa të arsyetuara për E. I. dhe 5 mungesa të arsyetuara për K.I. Në këtë kontekst, vihet re disniveli tepër i madh ndërmjet mungesave të vajzave në klasën e IX, ku numri i tyre është mbi 100 të tilla. Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se në referencë të nenit 22, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), në kushtet kur klasa e pestë bën pjesë në arsimin fillor, ku nxënësit ende marrin mësim vetëm nga një mësuese, ndërkohë që AMU⁴ fillon nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese do të merren parasysh dëftesat e lëshuara për vajzat përgjatë AMU-së.

⁴ AMU - Arsimi i mesëm i ulët;

Referuar vërtetimeve të notave, rezulton se notat e lëndës Italisht, të cilën e jepte mësuesja kujdestare B. P.për të dyja vajzat janë pothuajse konstante. Ema Ismaili është vlerësuar për 3 vite me notën 7 (shtatë)⁵ dhe 1 vit me notën 8 (tetë)⁶. Katja Ismaili është vlerësuar për 2 vite me notën 7 (shtatë)⁷, 1 vit me notën 8 (tetë)⁸ dhe 1 vit me notën 6 (gjashtë)⁹.

Njëkohësisht, mbështetur në aktet e administruara rezulton se mësuesja e histori-gjeografisë, znj. A. R. i ka vlerësuar E. dhe K. I., nga klasa VI-IX, me nota konstante 7-8 në lëndët e Historisë dhe Gjeografisë, nga klasa VI – IX.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk konstaton rënie të ndjeshme në mësimet nga klasa VI, deri në klasën IX, të E. dhe K. I. Njëkohësisht, notat e marra në lëndët që japin mësueset subjekt ankese kanë qenë pothuajse të njëjta përgjatë AMU-së.Ndërkohë, që konstatohet rritja e konsiderueshme e numrit të mungesave nga klasa VI, në klasën IX. Në seancë dëgjimore mesuesja kujdestare B. P.dhe drejtoresha e shkollës u shpreh se vajzat mungonin shpesh ose largoheshin nga mësimi, ndaj për këtë arsye kanë njoftuar edhe prindin.

Lidhur me çështjen e kryerjes së mungesave në shkollë, drejtuesja e shkollës ka përcjellë me shkresë zyrtare, disa printime të bisedave me mesazhe ndërmjet mësueses kujdestare B. P.dhe znj. V. A., përgjatë vitit 2018. Referuar mesazheve në fjalë rezulton se znj. V. A. e ka njoftuar shpesh herë, znj. B. P.për mungesat e vajzave për arsye të ndryshme, kryesisht shëndetësore. Nga analizimi i këtyre mesazheve rezultoi se ankuesja nuk ka shprehur asnjëherë shqetësime të natyrës së bullizmit, që të justifikojë mungesat e vajzave të saj. Ky fakt është justifikuar gjatë hetimit administrativ, pasi ankuesja e ka theksuar faktin, se ajo ka marrë dijeni për bullizmin e ushtruar ndaj vajzave të saj, pasi ato kishin përfunduar shkollën 9-vjeçare.

Një element tjetër, tek i cili, u fokusua hetimi i Komisionerit ishte edhe reagimet dhe sjelljet e dy vajzave në ambientet e shkollës, fakt i vënë në dukje nga mësuesja kujdestare dhe Drejtoresha e shkollës. Kjo e fundit, theksoi në mënyrë të përsëritur faktin se vajzat ishin rebele e përdornin fjalor të pahijshëm, si dhe shpesh kishin zënka me nxënës të tjerë. Titullarja aktuale e shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, ka kundërshtuar pretendimet e ankueses duke i konsideruar të pabazuara, si dhe ka shprehur vlerësimin maksimal për mësueset e sipërpërmendura. Gjatë seancës dëgjimore, titullarja e këtij institucioni arsimor, e cila në kohën, për të cilën kryhet

⁵ Vlerësim për klasën e VI, VIII, IX;

⁶ Vlerësim për klasën e VII;

⁷Vlerësim për klasat e VIII dhe IX;

⁸ Vlerësim për klasën e VII;

⁹ Vlerësim për klasën e IV;

shqyrtimi administrativ i ankesës, ka qenë nëndrejtoreshë e kësaj shkolle, u shpreh se K. dhe E. I. kanë shfaqur problematika në ambientet e shkollës, duke filluar që nga largimet nga mësimi apo mungesat në shkollë, e deri tek sjelljet dhe fjalët e pahijshme në ambientet e shkollës.

Në këtë kontekst, Komisioneri i është referuar Dëftesave të Lirimit të dy nxënësve, që i përkasin vitit shkollor 2017-2018 dhe përkatësisht Rubrikës “Karakteristikat e Nxënësit”, ku shprehimisht për nxënëset E. dhe K. I., citohet: *“Sjellja shumë mirë. Vëmendje dhe pjesëmarrje jo e vazhdueshme gjatë aktivitetit shkollor. Sjellje në përgjithësi korrekte dhe me edukatë. Respekton Rregulloren e Brendshme.* Për sa më sipër, Komisioneri konstaton mospërputhje ndërmjet dëshmisë së drejtueses aktuale të kësaj shkolle, në seancë dëgjimore, me karakteristikat e shkruara në Dëftesat e Lirimit të dy vajzave, të cilat janë nënshkruara nga ish drejtuesja e këtij institucioni arsimor.

Pavarësisht sa më sipër, duke marrë të mirëqenë dëshminë e drejtueses aktuale të Shkollës 9–vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, në kushtet kur, vajzat kanë shprehur problematika në sjelljet e tyre, Komisioneri kërkoi të administronte aktet e psikologut të shkollës, për të evidentuar mënyrën se si ka reaguar institucioni arsimor, për të ndrequr situatën e krijuar dhe për të kuptuar se ku konsistonte problemi me dy nxënëset, të cilat rrinin të veçuara, shfaqnin sjellje rrebele e të pahijshme në ambientet e shkollës dhe largoheshin nga mësimi, ose mungonin me ditë të tëra në shkollë. Në gjykimin e KMD-së, kryerja e mbi 100 mungesave në orët mësimore nga ana e Ema dhe Katja Ismaili, konsiderohet një rast, i cili nuk duhet të dilte jashtë vëmendjes së mësueses kujdestare dhe drejtuesve të shkollës. Mësuesja kujdestare është shprehur që rastet kur vajzat kanë paraqitur problematikat e mësipërme, i ka raportuar dhe adresuar në Drejtorinë e Shkollës. Në vijim të faktit të mësipërm, Komisioneri ka hetuar mbi veprimet rregulluese, që duhet të kishte ndërmarrë drejtoria e kësaj shkolle, për të identifikuar shkakun e problematikave që ekspozonin dy vajzat binjake, të cilat sikurse është përmendur edhe në Raportin e Vëzhgimit të ZVA Tiranë, vinin nga një familje me probleme sociale. Gjatë procesit të hetimit administrativ rezultoi se të dy vajzat, kanë mësuar me të njëjtët nxënës, në të njëjtën klasë, përgjatë gjithë AMU-së. Problemet e bullizmit të pretenduar nuk kishin lindur më parë, por vetëm në fund të klasës së tetë dhe përgjatë klasës së nëntë.

Mbështetur në Urdhërin nr. 344, date 19.8.2013, e Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen e Njesisë së Shërbimit Psiko-social” (i ndryshuar) pranë Shkollave 9-vjeçare është krijuar dhe funksionon që prej vitit 2013, Njësia e Shërbimit Psiko-Social. Në referencë të pikës 2, të Urdhërit të mësipërm, kjo njësi ka për detyrë të vlerësojë gjendjen psiko-sociale të nxënësve me problem në të nxënë, ose me problem të sjelljes dhe në bashkëpunim me mësuesit e drejtuesit e institucioneve arsimore dhe prindërit planifikon dhe realizon shërbime që ndihmojnë në zhvillimin arsimor, social dhe personal të nxënësve.

Njëkohësisht, në nenin 20, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikohet shprehimisht: “1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore. 2. Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se nuk ekziston asnjë procesverbal dhe asnjë rekomandim i psikologut të shkollës mbi dy vajzat binjake. Vajzat gjithashtu theksojnë faktin se nuk kanë patur asnjëherë kontakt me psikologun e shkollës. Ky fakt që dëshmon se rasti i tyre nuk është marrë asnjëherë në trajtim nga psikologu i shkollës. Një gjë të tillë e provon edhe akti “Relacion informues përmbledhës nga zyra e shërbimit psikologjik në shkollë mbi verifikimin e informacionit për 2 nxënësit e shkollës me kërkesë të drejtorisë”, i datës 16.12.2019, i hartuar nga psikologjia aktuale e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë.

Në këtë akt citohet si vijon:

“...Nxënësit E. dhe K. I. rezultojnë që të mos kenë patur nevojë për ndërhyrje të shërbimit psikologjik. Referuar dosjeve të kësaj periudhe nuk ka asnjë shënim dhe dosje të hapur, nuk ka asnjë informacion të mbajtur në procesverbalet nga problematikave dhe relacionet me mësuesit e shkollës, nuk ka shënime nga harta-sociale e klasës për nxënësit në fjalë, nuk ka asnjë informacion të referuar nga klasa apo familja. Duke iu referuar këtyre raportimeve të mësipërme deklarohet me kompetencë të plotë se vajzat në fjalë, ish-nxënëse të shkollës nuk janë referuar pranë zyrës së shërbimit psikologjik dhe nuk ka asnjë shënim të mbajtur për to.”

Për sa më sipër, vlen të theksohet fakti se psikologjia që ka hartuar raportin e mësipërm, nuk është e njëjta psikologe, që ka punuar pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, gjatë periudhës, kur Ema dhe Katia Ismaili kanë mësuar pranë kësaj shkolle. Një fakt i tillë u bë i ditur në seancë dëgjimore nga ana e drejtueses aktuale të kësaj shkolle. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se dalja në përfundimin e sipërpërmendur se: “Nxënësit Ema dhe Katia Ismaili rezultojnë që të mos kenë patur nevojë për ndërhyrje të shërbimit psikologjik “ është i pambështetur, për sa kohë që këto nxënëse nuk janë marrë në trajtim dhe as janë takuar ndonjëherë me psikologun e shkollës gjatë periudhës, kur pretendohet bullizimi i tyre. Një përfundim i tillë është i pabazë sidomos në kushtet kur psikologjia aktuale nuk i njeh fare nxënësit dhe as problematikave të tyre.

Për sa më sipër, referuar edhe dëshmisë së psikologes së ZVA Tiranë, e cila mori pjesë në seancë dëgjimore, rezulton se ose rasti konkret i E. dhe K. I. nuk ka qenë aq problematik dhe madhor, sa t'i adresohet psikologut të shkollës, ose me këtë rast është neglizhuar nga personat përgjegjës.

Mbështetur në shkresën nr. 4000, datë 21.10.2019, të ZVA Tiranë, nëpërmjet së cilës përcillet Raporti i Vëzhgimit i grupit të kontrollit të këtij institucioni, i ngarkuar për të hetuar rastin e E. dhe K. I., rezulton se: *“Bazuar në gjetjet dhe gjykimet e mësipërme grupi i vëzhgimit ka arritur në konkluzionin se: Nxënëset vijnë nga një familje me problem sociale, të rritura vetëm me nënërin prind dhe ëma e tyre i ka edukuar të rrinë gjithmonë të veçuara nga pjesa tjetër e botës. Për këtë arsye vajzat nuk pranonin të socializoheshin me bashkëmoshatarët e tyre dhe kishin problem në komunikimin me shokët deri tek përdorimi i fjalorit të pahijshëm. Mësuesja kujdestare e tyre Znj. B. P. është munduar t'i vijë në ndihmë vajzave duke i ofruar komunikimin e afërt, aktivizimin e tyre me shokët, shoqet e klasës, afrimin e tyre dhe socializimin me bashkëmoshatarët e tyre, por vajzat duke qenë se ishin edukuar me frymën e vecimit nga e ëma Znj. V. P., e cila e ka pranuar vetë këtë fakt para mësueses dhe Drejtoreshës së shkollës, e kishin të vështirë të krijojnë një rreth shoqëror në shkollën ku ato ishin. Staf i drejtues ka zbatuar legjislacionin në fuqi duke mbajtur në procesverbal ankesat e bëra nga e ëma e vajzës, duke pritur dhe sqaruar tezen e nxënëseve për ankesën e saj të bërë gojarisht në shkollë. Në datë 03.12.2018 shkolla “Qazim Turdiu” ka zhvilluar edhe një anketë në shkollë mbi bullizmin. Nga rezultatet e anketimit nuk rezultoi që këto mësuese kishin probleme në shkollë. Mësuesja kujdestare Znj. B. P. ndaj së cilës bie akuza kryesore është treguar e gatshme ndaj grupit të monitorimit, ndaj prindit të vajzave, ndaj tezes së tyre dhe shprehet e gatshme për çdo lloj sqarimi me nxënëset E. dhe K. I. Mësuesja tjetër ndaj së cilës ishte drejtuar akuza e bullizmit Znj. A. R. nuk mund të paraqitet në shkollë për arsye të rënda shëndetësore pasi po vuan kurimin e një sëmundjeje të rëndë prej kohësh.”*

Për sa më sipër, pas analizimit të Raportit të mësipërm, Komisioneri konstaton se edhe vëzhguesit e këtij institucioni kanë konstatuar se vajzat realisht kishin probleme, që manifestoheshin tek komunikimi me shokët, përdorimi i fjalorit të pahijshëm, mungesat e shumta në mësim etj. Në këtë kontekst, ky Raport ndihmon procesin e të provuarit në këtë hetim administrativ, për sa i përket problemeve që E. dhe K. I. realisht kanë patur në ambientet shkollë, si dhe dëshmon në moszbatimin e kuadrit ligjor nga drejtorja e kësaj shkolle dhe mësuesja kujdestare B. P., për t'u ofruar këtyre vajzave shërbimin e psikologut të shkollës. Komisioneri gjykon se rasti i vajzave ka qenë rast, i cili duhej marrë në trajtim nga psikologu i shkollës, i cili duhet të jepte rekomandimet përkatëse për të qetësuar situatën e për të kuptuar e identifikuar realisht problemin e tyre. Në mungesë të trajtimit të duhur nga ana e një psikologu, situata e vajzave është rënduar e derivuar, duke pasjellë mungesa të shumta në shkollë, rebelizëm

në sjelljen e tyre, anemi nga mungesa e marrjes së ushqimit, e deri në dyshim anoreksie. Këto probleme kanë lënë pasojë afatgjata, pasi kanë vijuar edhe pas përfundimit të shkollës 9-vjeçare.

Vëzhguesit e Zyrës Vendore Arsimore Tiranë kanë kryer edhe një vëzhgim të orientuar pranë Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, pjesë e të cilit ka qenë edhe një anketim për nxënësit e kësaj shkolle, për të kryer verifikimet përkatëse mbi bullizmin e pretenduar ndaj E. dhe K. I. Pjesë e anketimit kanë qenë 62 nxënës të klasës VII-të, ku znj. B. P. është mësuese kujdestare e klasës, që prej vitit të kaluar, si dhe 37 nxënës të përzgjedhur në mënyrë rastësore në dy klasa të VIII-ta, ku znj. A. R. dhe znj. B. P. u kanë dhënë mësim këtyre nxënësve që prej klasës VI dhe vazhdojnë t’u japin edhe gjatë këtij viti shkollor. Anketimi ka synuar të hulumtonte praninë e problematikave mbi marrëdhëniet mësues-nxënës në klasat, ku mësueset jepnin mësim. Nga rezultatet e anketimit rezultoi se mësueset e sipërpërmendura nuk kishin problem në shkollë.

Përveç anketimit të sipërpërmendur, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë ka depozituar në cilësi prove pranë KMD-së edhe rezultatet e anketimit të kryer nga psikologjia e shkollës. Anketa në fjalë është emërtuar **“Raporti Nxënës – Mësues – Shkollë”**. Referuar Relacionit Përfundimtar dhe analizave statistikore dhe përshkruese të nxjerra nga anketa vlerësuese me nxënësit rezultoi se: “ ...Nxënësit shprehën bindshëm se shumica e mësuesve kujdesen për ta dhe jua lehtësojnë çdo problematikë apo situatë që nuk ka lidhje me mësimin drejtpërdrejtë. Nxënësit gjithashtu ndjehen të vlerësuar nga rezultatet e marra dhe shumë motivues për të mësuar e vazhduar më tej. Pjesa më e madhe pohojnë se ndjehen të mirëpritur në shkollë, ku pjesa më e madhe e mësuesve i njohin dhe i mbështesin në çdo shqetësim, apo situatë kurdoherë që ata kanë nevojë. Nxënësit kanë një marrëdhënie dhe raport të admirueshëm mes shokësh në klasë dhe grup.... ”.

Pavarësisht përfundimit të mësipërm, Komisioneri gjykon se E. dhe K. I. janë ndodhur para një presioni të madh, në ambientet shkollorë. Si pasojë e këtij presioni, vajzave iu ka humbur dëshira për të frekuentuar shkollën dhe kanë derivuar në probleme të tjera, që janë reflektuar në mos ushqyerje, përdorim të veshjeve të errëta, mbyllje në vetëvete e veçim. Fakti që, vajzat janë veçuar nga pjesa tjetër e klasës dëshmon se ato nuk ndjeheshin mire në ambientin rrethues dhe me individët që kishin pranë, nga të cilët fyheshin, talleshin e ofendoreshin. Komisioneri çmon se veçimi i tyre ka qenë i imponuar nga ambienti rrethues. Komisioneri gjykon se nëse nëna e tyre do t’i kishte këshilluar vajzat për veçim nga të tjerët, një gjë e tillë do të kishte ndodhur edhe më parë, jo në klasën e VIII apo të IX. Znj. V. A. mund të ketë ndikuar në forcimin e lidhjes ndërmjet vetë vajzave me njëra tjetrën, por jo në veçimin e tyre nga shokët e klasës, nëse ata do të kishin patur qëllime shoqërore dhe jo bulliste.

Nga faktet e administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioneri përfundimisht gjykon se të gjitha këto pasoja tek të dy vajzat janë rrjedhim i bullizmit të ushtruar nga shokët e klasës. Sikurse rezulton nga dëshmitë e dhëna në seancë dëgjimore, ashtu edhe në Raportin e ZVA Tiranë, çështja e bullizmit të pretenduar nga E. dhe K. I. nuk është çështje që është shfaqur vetëm në ankesën e KMD-së, por nga faktet rezulton se pas mbarimit të vitit shkollor 2017-2018, në Shkollën 9-vjeçare “Qazim Turdiu” është paraqitur tezja e vajzave, e cila ka bërë ankesë verbale, ku ka ngritur pretendimin se të dyja mbesat e saj nuk po vazhdojnë dot shkollën pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”, si pasojë e bullizmit të trashëguar nga shkolla 9- vjeçare, pasi të njëjtët nxënës që mësonin pranë kësaj shkolle, kanë kaluar në gjimnazin e sipërpërmendur. Njëkohësisht, ankuesja V. A. ka depozituar ankesë me shkrim pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, në fillim të muajit shtator 2019, ku parashtron pretendimin e bullizmit të ushtruar ndaj vajzave të saj, gjatë fundit të klasës së tetë e gjatë gjithë periudhës që ato kanë vazhduar klasën e nëntë. Ankuesja ka theksuar faktin se nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare mbi çështjen e parashtruar, nga Shkolla 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Një fakt i tillë e penalizon stafin drejtues të kësaj shkolle.

Për sa më sipër, Komisioneri çmon se për vetë periudhën kohore, për të cilën bëhet fjalë, nuk ka qenë e mundur të sigurohen prova konkrete dhe të drejtpërdrejta, që të vërtetojnë ndikimin apo përfshirjen e mësueseve B. P. dhe A. R., në bullizmin e ushtruar mbi vajzat binjake Ema dhe Katja Ismaili, nga shokët e klasës. Njëkohësisht, faktet e administruara në cilësinë e provës nuk dëshmojnë pro pretendimit të ankueses, ndaj dy mësueseve B. P.dhe Ariana Rexhamati. Por, pavarësisht sa më sipër, problematikat që dy vajzat kanë patur janë të pamohueshme, që kanë ardhur si rrjedhim i bullizmit nga shokët e klasës.

Komisioneri gjykon se të dy vajzat duhet të kishin marrë ndihmën e psikologut të shkollës në momentin e duhur, pasi këshillimi dhe trajtimi nga ana e tij ka qenë tepër i nevojshëm për dy vajzat, gjatë periudhës që ato ndiqnin Shkollën 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se shërbimi i psikologut të shkollës nuk u është ofruar E. dhe K. Ismailit, pavarësisht se janë identifikuar dhe kanë shfaqur problematika, të cilat duheshin trajtuar nga një specialist i tillë.

Gjatë seancës dëgjimore, rezultoi se zinxhiri raportues, në lidhje me problematikat e nxënësve ishte **“mësues kujdestar – drejtorja e shkollës – psikolog”**. Mësuesja kujdestare theksoi faktin se problematikat e kontatuara tek Ema dhe Katja Ismaili i kishte referuar tek drejtorja e shkollës dhe nga sa u konstatua gjatë procesit të hetimit administrative, drejtuesja aktuale e kësaj shkolle ishte e mirë informuar, lidhur me problemet, që kishin shfaqur vajzat në shkollë. Në këtë

kontekst, Komisioneri krijon dyshimin e arsyeshem që drejtoria e kësaj shkolle nuk e ka referuar për shqyrtim rastin e E. dhe K. I., tek psikologu i shkollës, duke e neglizhuar një rast të tillë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se Drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, ka patur detyrim ligjor, që dy vajzave t’u ofronte shërbimin e psikologut të shkollës. Në interpretim të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”, Komisioneri çmon se Drejtoria e Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë i ka ekspozuar E. dhe K. I., ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 106, datë 03.09.2019, e Znj. V. A., pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore”, nga ana e e Znj. B. P.dhe Znj. A. R., mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë.

“Gjendja shoqërore” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore”, Komisioneri gjykon se ky konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Në ankesën nr. 106, datë 03.09.2019, e Znj. V. A., pretendohet diskriminimi i vajzave të saj, binjake, 16 vjeçare, për shkak të “gjendjes shoqërore”, nga ana e Znj. B. P.dhe Znj. A. R.,

mësuese pranë Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se E. dhe K. I. janë ekspozuar jo vetëm ndaj bullizmit të shokëve të klasës, por edhe ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Drejtorisë së Shkollës 9- vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, pasi ky institucion nuk u ka ofruar shërbimin e psikologut, në kushtet e problematikave, që vajzat kanë shfaqur në ambientet e shkollës.

Bullizmi ndodh në një kontekst social i cili përfshin; bullistin, viktimën, prindërit, mësuesit, drejtuesin e shkollës dhe psikologun e shkollës. Shumica e përkufizime të bullizmit e përcaktojnë atë si një seri sjelljesh agresive, të cilat përfshijnë qëllimin për të dëmtuar personin tjetër. Në Shqipëri, por jo vetëm, rolin e psikologut në shkolla e kanë lidhur ngushtë me fenomenin e bullizmit, i cili raportohet se ndodh shpesh në shkollat shqiptare, duke u manifestuar në forma të ndryshme. Psikologu shkollor rekomandohet si profesionisti kyç në zbatimin e një ndërhyrjeje të integruar sistemike të menaxhimit pozitiv të bullizmit në Shkollë.

Studimi, nga i cili janë tërhequr edhe shifrat e para treguese të prezencës së bullizmit në shkolla në Shqipëri, është studimi i kryer nga Qendra e Zhvillimeve Humane (2007), “Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri”. Ky studim, i kryer në shkallë vendi, tregoi se është momenti që kërkimet dhe programet e ndërhyrjes të fokusohen drejt formave specifike të dhunës, e tillë siç është bullizmi. Nga ky studim kombëtar, rezulton se një ndër format më tipike të dhunës psikologjike të ushtruar ndaj nxënësve në shkolla, kërcënimi zë vendin e parë. Ndërkohë që ka forma të tjera të shfaqjes së tij, duke përfshirë këtu bullizmin fizik, atë elektronik etj. Referuar Studimit Kombëtar¹⁰ për bullizmin dhe ekstremizmin të kryer në shkollat e Shqipërisë (2017) rezultoi që 1 në 5 nxënës nga klasa e IV deri në klasën e XII, janë të prekur nga bullizmi në shkollë. Rreth gjysma e të prekurve vuajnë nga bullizmi psikologjik, 35 për qind nga ai verbal dhe dhe pjesa tjetër nga bullizmi fizik Studimi përforcoi më shumë idenë se bullizmi si fenomen është prezent dhe po shtohet në shkollat e Shqipërisë.

Ndihma e parë që i duhet dhënë një nxënësi mbi të cilin, është ushtruar bullizëm është pikërisht ndihma e psikologut të shkollës. Mësuesit dhe drejtorja e shkollës jo gjithmonë mund të kenë informacion mbi bullizmin e ushtruar mbi një nxënës, por kur konstatojnë ndryshim të sjelljes së tij, veçim, mungesa të shumta në shkollë, reagimi minimal i tyre duhet të jetë zbulimi i shkakut të këtij ndryshimi tek ky nxënës. Në rastin konkret, Drejtorja e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë duhet të kishte reaguar pas raportimeve, që mësuesja kujdestare ka kryer për problematikat e shfaqura nga E. dhe K. I. Referuar Raportit të ZVA Tiranë, dy vajzat binjake

¹⁰Studim i Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, publikuar në 11 prill të vitit 2017;

janë konsideruar se vijnë nga një familje me probleme sociale, pasi janë rritur më një prind, i cili i ka ushqyer me ndjenjën e veçimit ndaj shoqërisë. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se këto vajza janë paragjykuar nga personat përgjegjës në drejtorinë e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, lidhur me gjendjen e tyre shoqërore dhe janë neglizhuar për t’u referuar për trajtim nga psikologu i shkollës, pasi janë konceptuar se probleme të tilla janë normale për këto vajza, duke gjykuar mbi gjendjen e tyre shoqërore. Pasojat e bullizmit, që është ushtruar ndaj vajzave, kanë zgjatur edhe pas përfundimit të shkollës 9-vjeçare.

Në analizë të Rregullores së Brendshme e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, për vitin shkollor 2019-2020, rezulton se ky akt, i miratuar në muajin shtator të vitit 2019 përmban parashikime lidhur me ndalimin e bullizmit të mësuesve ndaj nxënësve, si dhe bullizimin ndërmjet vetë nxënësve të kësaj shkolle. Nga analizimi i këtij akti, Komisioneri konstatoi se në përmbajtjen e saj, kjo rregullore nuk përmban asnjë parashikim lidhur me ndihmën, që duket të marrin nxënësit e bulluar, apo ato me probleme të ndryshme në të nxënë apo në sjellje nga psikologu i shkollës. Në këtë Rregullore mungon gjithashtu edhe përcaktimi i procedurës që duhet ndjekur, sipas shkallës hierarkike, për raportim dhe referim të rasteve në nevojë për këshillim tek psikologu i shkollës.

Në nenin 5, të ligjit nr. 69/2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”* (i ndryshuar) parashikohet shprehimisht: *“Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.”* Njëkohësisht, në nenin 20, të ligjit të sipërmendur parashikohet se: *“1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore. 2. Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.”*

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, diskriminimi përkufizohet si: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se E. dhe K. I., ish-nxënëse të Shkollës 9-Vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë janë diskriminuar nga ana e drejtorisë së kësaj shkolle, për shkak të gjendjes së tyre, shoqërore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 17 e 19, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 5 e 20 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), si dhe Urdhërin nr. 344, datë 19.8.2013, e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen e Njesisë së Shërbimit Psiko-Social” (i ndryshuar)

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të E. dhe K. I., për shkak të gjendjes shoqërore, nga Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të E. dhe K. I., për shkak të gjendjes shoqërore, nga mësueset B. P.dhe A. R.
3. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme, që situata të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen dhe fëmijët me probleme në sjellje të trajtohen menjëherë nga psikologu i shkollës.
4. Të kryhen shtesat e nevojshme në Rregulloren e Brendshme të Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, lidhur me rastet e nxënësve, që duhet të marrin ndihmën e psikologut në shkollë, si dhe mbi mënyrën dhe procedurën, që duhet ndjekur për të raportuar dhe përcjellë rastet përkatëse tek psikologu i shkollës
5. Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi të hartohet një plan masash, nga ana e ZVA Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë, kundër bullizimit, si fenomen që, ndodh shpesh në raportin nxënës me nxënës dhe mësues me nxënës.
6. Të merren masa nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë, për afishimin e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në ambientet e brendshme të të gjitha shkollave, që ndodhen nën juridiksionin e saj.

7. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Qazim Turdiu”, Tiranë dhe Zyra Vendore Arsimore Tiranë të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
8. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
9. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Shkak – gjendja shoqerore
Fusha - arsim